

ABU SEMAN
Nr. Prot 522
Dt 03/05/2018



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KËSHILLI KOMBËTARI I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 19 Datë 12/04/2018

Per miratimin e kërkesës, për ndryshimin e te dhenave ne lejen me Nr 17 date 16.11.2017 per përdorimin e burimit ujore te lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie nepermjet Hecit te Bletezes nga subjektin "CLAUBEL" sh.p.k. në Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

Në mbështetje te ligjit 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit te Ministrave "Per miratimin e kushteve te pergjitheshme e te posacme, dokumentave shoqeruese, afatit te vlefshmerise, formularve te aplikimit per autorizim dhe leje, procedurave te shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve te autorizimit e lejes per përdorim te burimeve ujore". Vendimit te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Basenit Ujore si dhe Vendimi te Keshillit Kombetare te Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per funksionimin e Agjencise se Basenit Ujor" Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin e kërkesës, për ndryshimin e te dhenave ne lejen Nr 17 date 16.11.2017 per përdorimin e burimit ujore te lumit Devoll, për prodhim hidroenergjie nepermjet Hecit te Bletezes nga subjektin "CLAUBEL" sh.p.k. në Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

HEC BLETEZA

Vepra e marrjes

X=4439200

Y=4516840

Z=277m

Prurja mesatare 27.3 m³/sek.

Prurja llogaritore: 30 m³/sek.

Prurja ekologjike: 4.05 m³/sek

Godina e centralit

X=44 37 237

Y=45 18 182

Z=257m

Fuqia e instaluar e Hidrocentralit do te jete rreth 1950 kW.

Per përdorimin e ketij burimi ujor duhet te plotesohen kushtet e meposhme:

- Te mos cenoj furnizimin me uje te popullates dhe te industrise per nevojat e tanishme dhe te prespektives.
- Te zbatoj grafikun per vaditje ne kohe (dite) dhe ne sasi (l/s) per cdo vite te hartuara nga Bordet e Kullimit te pushtetit vendore dhe ate Qendrore.
- Te respektoj grafikun e vaditjes edhe jashte periudhes kur e kerkon Bordi i Kullimit.
- Te respektoj rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotesuar kushtet e percaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet ABU Seman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI ABU SEMAN



Baki Bala